



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:003792

Datë: 22.11.2022

Numri i dokumentit: 03675265

PPP.nr.74/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, gjyqtari **Besmir Juniku**, në çështjen juridike të përmbartimit sipas propozimit për përmbartim të kreditorit J. S. nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson i autorizuari av.A. K. nga Prishtina, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit të përmbartuesit privat Eset Murati në Prishtinë, P.nr.1745/17 të datës 03.10.2017, me datë 22.11.2022 merr këtë:

A K T V E N D I M

I.PËRFUNDOHET procedura e përmbartimit në lëndën PPP.nr.75/2019 sipas propozimit për përmbartim të datës 03.10.2017 të kreditorit J. S. nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit i paraqitur kundër debitorit Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë në bazë të dokumentit përmbartues Aktgjykimit të plotfuqishëm të kësaj gjykate C.nr.122/2012 të datës 25.11.2013 me ndryshimet sipas Aktgjykimit Ac.nr.214/2014 të datës 11.07.2017, për shkak të përmbushjes së kredisë-kërkesës.

II.Hiqet nga fuqia Urdhri i përmbartuesit privat Eset Murati në Prishtinë, P.nr.1745/17 i datës 03.10.2017, ashtu që prishen të gjitha veprimet përmbartimore të ndërmarrura nga i njëjti.

III.Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesi J. S. nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, përmes të autorizuarit av.A. K. nga Prishtina ka parashtruar propozim për përmbartim në bazë të vendimit gjyqësor, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë, duke kërkuar përmbueshjen e kredisë në vlerën prej 57,520.00€uro. Përmbartuesi privat Eset Murati në Prishtinë, me Urdhrit përmbartimor P.nr.1745/17 të datës 03.10.2017 ka lejuar përmbartimin. Ndaj urdhrit përmbartimor debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim. Kjo gjykatë ka vendosur lidhur me

prapësimin sipas Aktvendimit PPP.nr.60/2017 të datës 30.11.2017, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me Aktvendimin Ac.nr.767/18 të datës 03.04.2019 vendimin e shkallës së parë e ka anuluar dhe çështjen përmbartimore e ka kthyer në rivendosje.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike dhe duke vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit ka caktuar seancë dëgjimore për datën 18.11.2022 në të cilën nuk kanë prezentuar palët ndërgjyëse. I autorizuari i kreditorit av.A. K. me parashtrësën e datës 31.10.2022 e ka njoftuar gjykatën se të gjitha kërkesat lidhur me këtë çështje përmbartimore debitorja i ka përmbushur dhe se nuk kemi asnjë pretendim lidhur me këtë çështje.

Sipas nenit 42 par.1 dhe 2 të LPP – së përcaktohet se *”1. Propozimi për përmbartim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbartimore pa pëlqimin e debitorit. 2. Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbartim organi përmbartues e përfundon përmbartimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht”*. Ndërsa neni 66 par.4 e përcakton se *”4. Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”*.

Meqenëse kreditori ka realizuar kërkesën në tërësi si në propozimin për përmbartim, gjykata e ka përfunduar procedurën përmbartimore.

Nga arsyet e theksuara, konform nenit 42 par.1 dhe 2 dhe nenit 66 par.4 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
PPP.nr.74/2019, datë 22.11.2022.

Gj y q t a r i
Besmir Juniku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej **7 (shtatë) ditësh**, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmjet kësaj gjykate.